



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 26 datë 10.11. 2014

PËR

**“PËRCAKTIMIN E STANDARDIT “LED” PËR SHËRBIMIN E NDRIÇIMIT
TË MJEDISEVE PUBLIKE TË QYTETIT TË TIRANËS DHE MIRATIMIN
E PROCEDURËS PËR REALIZIMIN E KËTIJ FUNKSIONI”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/I, shkronja “a”, nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3/I , shkronja “ç”, nenit 32, shkronja “k” dhe nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 21, datë 10.11.2011 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e standartit të teknologjisë “LED”, në lidhje me shërbimin e ndriçimit të mjediseve publike në qytetin e Tiranës.
2. Për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia e Tiranës duhet të përcaktojë procedurën për realizimin e tij, në përputhje me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Prokurimeve në Bashkinë e Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI